



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 350 prot.

Peshkopi, më 23.12.2020

VENDIM

Nr. 22 Datë 21 .12.2020

MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM
2022-2024

Mbeshtetur ne, Ligjin nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", neni 82 pika 2, Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", neni 33 pika 2, Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, Udhezimit te Ministrise te Financave nr.2, date 06.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar", Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 21.12.2020", Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 21.12.2020, pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë nr. 22, dt. 21.12.2020 per miratimin e kalendarit te projekt-buxhetit afatmesem 2022-2024, te Keshillit te Qarkut Diber, me 9 (nëntë) vota pro,

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit për programin buxhetor afatmesem 2022-2024.
2. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi ngarkohet GMS, dhe Sektori i Finances.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall sot më dt. 21 .12.2020

KRYETAR

Valentina Haliti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 348 prot.

Peshkopi, më 23.12.2020

V E N D I M
Nr. 20, date 21.12.2020

PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE NIVELIT TË PAGAVE
TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT DIBËR PËR VITIN 2021

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", neni 77, germa "ç", neni 82, germa "b", në Ligjin nr.7961, dt.12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet e mëvonshme, në Ligjin nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, në VKM nr.474, dt.16.06.2011 "Për përcaktimin e standarteve të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike". VKM nr. 142, date 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, në VKM nr. 177, date 8.3.2017 "Per disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.165, dt.2.3.2016", Keshilli i Qarkut Diber në mbledhjen e datës 21.12.2020, pasi shqyrtoi Vendimin e Kryesisw "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave të administratës së Këshillit të Qarkut Diber për vitin 2021", me 9 (nëntë) vota pro.

V E N D O S I:

1. Të miratojë strukturën e administratës së Këshillit të Qarkut, emërtimet e drejtorive, sektorevë dhe pozicioneve të punës, klasifikimin e pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil si dhe nivelin e pagës për çdo pozicion, sipas TABELAVE 1 dhe 2 që i bashkëlidhen këtij Vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë
3. Me zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe Projekteve, Sektori i Financës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.
5. U shpall sot, date 21.12.2020

KRYETAR
Valentina Halin





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI QARKUT DIBËR

Nr. 399 prot.

Peshkopi, më 28.12 2020

VENDIM

Nr. 21 Datë 21, 12.2020

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT DIBËR TË VITIT 2021

Në mbështetje të Ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Neni 8 pika 2, Neni 9 pika 1.1, Neni 31 pika 1.2.3, Neni 34, Neni 38, Neni 40, Neni 41, Neni 72 pika 5, Neni 77, Neni 83 pika ç; Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, neni 40; Ligjit 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjit nr. 2020 "Për buxhetin e vitit 2021", në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 9, dt. 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKM nr. 864 datë 23.7.2010" Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publik", Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 21.12.2020, pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë nr. 21, dt. 21.12.2020 "Për Miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Dibër për vitin 2021, me 9 vota pro,

VENDOSI:

I. Të miratojë të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2021 si më poshtë në lekë:

A. TË ARDHURA GJITHSEJ	68 497 678
I. Të ardhurat e veta	
a) Të ardhura kuota e antarësisë	3 584 110
b) Të ardhura nga shërbimet	206 400
c) Të ardhura transferta e pakushtëzuar 2021	37 003 000
d) Të ardhura (transferta e trashëguar) nga viti 2020	26 164 168
e) Të ardhura të trashëguara nga viti 2020	1 540 000

B. SHPENZIME GJITHSEJ 68 497 678

Shpenzimet e veta:

I. Shpenzime nga transferta e pakushtëzuar	63 167 168
a) Paga Personeli (llog 600)	15 204 000
b) Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore (llog 601)	2 539 068
c) Shpenzime Operative (llog 602)	13 208 966
d) Transferta (llog 604)	18 375 444
e) Transferta për org.ndërkomb AER (llog 605)	500 000
f) Transferta për buxhetet familjare dhe individët (llog 606)	400 000
g) Fondi i veçantë (llog 608)	760 200
h) Fondi rezervë (llog 609)	1 990 000
i) Investime (llog 231)	10 189 490
II. Shpenzime nga të ardhurat	5 330 510
a) Investime (llog 231)	5 330 510

2. Shpenzimet e pikës e pikës B/ I. II. do të përdoren sipas Pasqyrës 1 bashkëlidhur.
3. Të miratojnë limitin e përdorimit të telefonisë celulare për vitin 2021 brenda limitit 2% të Shpenzimeve Operative si më poshtë:
 - Kryetari i Këshillit të Qarkut limit mujor 10000 lekë
4. Të miratojnë PASQYRAT 1, 2, 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij
5. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut Brenda institucionit
6. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë
7. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
9. U shpall sot më dt. 21 .12.2020

KRYETAR

Valentina Haliti

